

# Ndikimi i granteve në prodhimin bujqësor

INSTITUTI GAP  
GAP INSTITUTE 



Korrik 2021

## Ndikimi i **granteve** në prodhimin bujqësor

Korrik 2021

### — Përmbajtja

<b>1.</b>	<b>Hyrje</b>	<b>3</b>
<b>2.</b>	<b>Përmbajtja e granteve</b>	<b>4</b>
2.1	Investimet në asete fizike të ekonomive bujqësore (Masa 101)	4
2.2	Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore (Masa 103)	6
2.3	Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve rurale (Masa 302)	7
2.4	Zbatimi i strategjive zhvillimore lokale - qasja LEADER (Masa 303)	8
2.5	Masa për ujitjen e tokave bujqësore	9
<b>3.</b>	<b>Përfundimi</b>	<b>10</b>

## 1. Hyrje

Sektori i bujqësisë përkrahet nga Qeveria e Kosovës në mënyrë direkte përmes fondeve në formë të subvencioneve dhe granteve. Grantet janë përkrahje financiare për projekte kapitale apo investime në infrastrukturën fizike në bashkëfinancim me fermerët dhe Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR). Këto fonde janë ndarë që nga viti 2007 në kuadër të programit zhvillimor 2007-2013, i cili më pas u zëvendësua me një verzion të rishikuar 2010-2013.<sup>1</sup> Ndërsa, në vitin 2013 është hartuar programi zhvillimor 2014-2020, në bazë të së cilës përgatiten programet vjetore. MBPZHR ka planifikuar rreth 23.1 milionë euro<sup>2</sup> çdo vit për grante për të mbështetur fermerët në kultura të ndryshme bujqësore, infrastrukturë fizike ekzistuese, pajisje bujqësore apo të gjithë ndërtimin.

Në dy raporte të ndara, Instituti GAP ka analizuar se si kanë ndikuar grantet dhe subvencionet<sup>3</sup> në prodhimin bujqësor. Këto dy hulumtime tregojnë se përkundër programeve dhe shumave që ndahen me rreth 48 milionë euro çdo vit për grante dhe subvencione, nuk janë arritur rezultatet e pritura. Zyra Kombëtare e Auditimit ka vlerësuar se menaxhimi i sektorit të bujqësisë nuk është bërë në mënyrë të duhur. Së pari, procesi i monitorimit të rezultateve të granteve aktuale ka mangësi dhe nuk siguron matjen e rezultateve dhe krijimin e zhvillimit të qëndrueshëm të këtij sektori. Gjatë vitit 2018, Ministria e Bujqësisë ka miratuar dy programe të veçanta që kanë kaluar buxhetin e planifikuar për grante gjatë vitit 2018, përfituesit e kësaj mase janë biznese që nuk e kanë veprimtari primare fushën bujqësore dhe është e pasigurt që mund të shfrytëzohen në mënyre efektive mjetet dhe të ketë rezultate të qëndrueshme.<sup>4</sup>

Së dyti, Kosova, për dallim nga vendet e rajonit, nuk përfiton fonde nga Bashkimi Evropian për financim dhe zbatim të masave dhe programeve të parapara. Edhe pse Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014-2020 është bazuar në parimet e Instrumentit për Asistencë në Para-Anëtarësim për Zhvillim Rural (IPARD), ka dështuar themelimi i këtyre strukturave.

Pastaj, bashkëpunimi ndërmjet MBPZHR dhe komunave nuk është i mirë, pasi që janë identifikuar raste kur fermerët për qëllime të njëjta kanë përfituar edhe nga ministria edhe nga komuna. Po ashtu, komunat nuk bëjnë kontrollimin e granteve dhe subvencioneve, dhe mungon informata e ndikimit të tyre në përmirësimin apo jo për qëllimin apo kulturën bujqësore që janë dhënë.<sup>5</sup>

Detyrimet e parapara me kontratën e përfitimit nuk janë përmbushur nga fermerët. MBPZHR nuk ka plan për kontrole ex-post të mjeteve të ndara për grante dhe subvencione. Në disa prej mostrave të audituara nuk janë përdorur mjetet që janë përfituar nga projekti, nuk janë gjetur në objekt pajisjet e financuara, pas autorizimit të pagesave edhe pas një viti nuk është bërë funksionalizimi i pajisjeve.<sup>6</sup>

Nga viti 2015 deri më 2019 janë shpërndarë rreth 104.5 milionë euro në grante nga MBPZHR. Në këtë raport do të paraqesim ndarjen e granteve sipas masave për programin e zhvillimit rural prej vitit 2014 deri në vitin 2019 për sektorët për të cilët janë ndarë më shumë grante ndër vite.

1 Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Plani për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2010- 13. <https://bit.ly/2PCv3Fq>

2 Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë. Raporti i Gjellbër 2016-2020. Burimi: <https://bit.ly/3vORXKy>

3 Instituti GAP, 2021, "Ndikimi i subvencioneve në prodhimin bujqësor".

4 Zyra Kombëtare e auditimit. Prosesi i menaxhimit të granteve dhe subvencioneve në sektorin e bujqësisë. <https://bit.ly/3cp5hx8>

5 Ibid.

6 Ibid.

## 2. Përmbajtja e granteve

Zhvillimi i bujqësisë ka një rëndësi të veçantë ekonomike për vendin. Kjo për arsye se deficitit tregtar vazhdon të jetë tejet i lartë veçanërisht në produkte ushqimore. Në pesë vitet e fundit deficitit tregtar në produkte bujqësore është rritur për mbi 20%.<sup>7</sup> Kjo tregon se rritja e kërkesës së brendshme në masë të madhe plotësohet nga importit. Për këtë arsye zhvillimi i bujqësisë do të mundësonte zëvendësimin e importit, rritjen e ekonomisë së brendshme dhe rritjen e punësimit.

Qeveria e Kosovës ofron mbështetje edhe përmes granteve për rritjen e zhvillimit të sektorit bujqësor dhe konkurrencës në treg. Qëllimet kryesore të kësaj mbështetje janë rritja e prodhimit dhe përpunimit për bizneset vendore që merren me bujqësi, vende të reja të punës, përmirësimi i infrastrukturës, rritja e cilësisë së prodhimit, zhvillimi i qëndrueshëm rural e tjera.<sup>8</sup> Në vijim paraqiten ndarja e granteve sipas masve dhe nën masave.

### 2.1 Investimet në asete fizike të ekonomive bujqësore (Masa 101)

Kjo masë përfshin sektorin e pemëve frutore, pemëve të imta, sektorin e serrave, depotë për ruajtjen e perimeve, sektorin e mishit (trashja e viçave, derrave, brojlerëve), sektorin e qumështit (lopë qumështore, dele dhe dhi), sektorin e pikave grumbulluese, sektorin e rrushit si dhe sektorin e pulave. Objektivat e përgjithshme të kësaj mase janë: rritja e aftësisë konkurruese të bujqësisë në Kosovë dhe zëvendësimi i importit, përkrahja e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror nëpërmjet fermave duke synuar rritje të vazhdueshme dhe të qëndrueshme, krijimi i vendeve të reja të punës në zonat rurale, shfrytëzimi i energjisë së ripërtërishme.

**Tabela 1. Shuma e ndarë në euro për sektorët e masës 101 - Investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore**

Masa 101					
Viti	2015	2016	2017	2018	2019
Sektori pemë drufrutore	2,328,544	2,738,404	2,516,592	3,356,513	3,279,716
Sektori i pemëve të imta (manore)	1,369,558	3,127,843	1,662,916	-	-
Sektori serra	-	3,122,356	2,901,077	4,143,270	2,959,491
Depo për ruajtje të perimeve	3,275,341	746,136	443,290	1,316,850	493,127
Sektori i mishit (trashja e viçave)	1,408,771	1,738,044	1,619,448	2,469,319	2,011,862
Sektori i mishit (rritja e brojlerëve)	800,987	567,871	592,803	-	-
Sektori i mishit (trashja e derrave)	-	-	142,272	260,154	242,431
Sektori i qumështit (lopët qumështore)	2,038,112	1,572,852	1,616,526	3,242,901	1,488,028
Sektori i qumështit (dele dhe dhi)	791,575	705,332	501,897	1,205,620	504,600
Pika grumbulluese	-	-	163,780	93,807	115,540
Sektori i rrushit	350,682	577,004	279,992	594,519	622,807
Sektori i vezëve	295,512	338,499	349,986	214,562	318,203

Burimi: Raporti i Gjellbër 2016- 2020 i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

<sup>7</sup> Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë. Raporti i Gjellbër 2020. Burimi: <https://bit.ly/3vORXKy>

<sup>8</sup> Ibid.


**Tabela 2. Indikatorët e performancës së granteve për sektorin e pemëve druftore.**

Viti	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Grante (euro)	1,165,703	2,328,544	2,738,404	2,516,592	3,356,513	3,279,716
Prodhimtaria (ton)	23,875	40,423	45,899	23,976	42,235	54,766
Sipërfaqja (ha)	3,135	4,113	4,303	4,438	5,217	6,210

Burimi: Raporti i Gjelbër 2015- 2020 i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Pemët druftore përbëjnë pjesën më të madhe të granteve si dhe përfshijnë pemët si: mollë, dardhë, kumbull, vishnje, qershi, kajsi, pjeshkë dhe ftua. Disa nga objektivat e veçanta të kësaj nën mase janë rritja e prodhimit të pemëve, modernizimi i fermave përmes pajisjeve të reja, prodhimi i energjisë së ripërtrishme, përmbushja e standardeve të BE-së dhe atyre kombëtare sipas cilësisë.

Që nga viti 2014, grantet për pemë druftore janë rritur për 181%. Shuma më e lartë e granteve për pemë është ndarë gjatë vitit 2018. Prodhimtaria dhe sipërfaqja e mbjellur e pemëve druftore është rritur kënaqshëm gjatë këtyre viteve. Rënie më të theksuar në prodhimtari kemi gjatë vitit 2017.

**Figura 1. Indikatorët e performancës së granteve për sektorin e pemëve druftore.**

Burimi: Raporti i Gjelbër 2015- 2020 i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Në anën tjetër, përkundër investimeve në asete fizike në sektorin e prodhimit të qumështit, numri i krerëve të lopëve qumështore, deleve dhe dhive së bashku me prodhim ka rënë. Ndërsa importi i produkteve prej qumështit vazhdon të jetë i lartë.<sup>9</sup>

9 Ndikimi i subvencioneve në prodhimin bujqësor. Instituti GAP.

## 2.2 Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore (Masa 103)

Kjo masë përfshin sektorin e përpunimit të qumështit, sektorin e përpunimit të mishit, sektorin e përpunimit të pemëve dhe perimeve si dhe sektorin e prodhimit të verës. Kjo masë është projektuar për ta plotësuar Masën 101, me qëllim të prodhimit të produkteve bujqësore pa ndikime negative në mjedis. Objektivat e përgjithshme të kësaj mase janë rritja e aftësisë konkurruese dhe zëvendësimi i importit, përmes rritjes së produktivitetit dhe futjes së teknologjive dhe produkteve të reja, rritja e sigurisë dhe cilësisë së produkteve, përkrahja e ndërmarrjeve në sektorët e përzgjedhur, me qëllim të përafrimit me politikën dhe praktikën e BE-së dhe përmirësimet në mbrojtjen e mjedisit, mirëqenien e kafshëve dhe menaxhimin e mbeturinave dhe shfrytëzimi i energjisë së ripërtërishme.


Nën masa e sektorit të përpunimit të pemëve dhe perimeve kanë përfituar më së shumti grante gjatë këtyre viteve me rreth 9.6 milionë euro.

**Tabela 3.** Shuma e ndarë në euro për sektorët e masës 103 - Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore

Masa 103						
Viti	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Sektori i përpunimit të qumështit	1,374,203	1,005,740	706,551	-	733,149	191,760
Sektori i përpunimit të mishit	1,234,948	1,604,928	1,475,881	-	578,442	181,674
Sektori i përpunimit të pemëve dhe perimeve	1,296,664	2,244,316	2,106,402	396,794	2,877,805	720,865
Sektori i prodhimit të verës	249,404	386,675	372,948	562,230	653,184	187,500

Burimi: Raporti i Gjellbër 2015- 2020 i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

**Figura 2.** Industria përpunuese si pjesë e Bruto Produktit Vendor me çmime konstante 2015-2020



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Industria përpunuese është rritur ndër vite duke arritur në mbi 911 milionë euro të Bruto Produktit Vendor në vitin 2020.<sup>10</sup> Por, për shkak që nuk kemi të dhëna të ndara në nën-sektor është e vështirë të bëhet vlerësimi nëse është arritur targeti i synuar për këtë masë pas shpërndarjes së granteve. Për një vlerësim më të saktë, duhet të shikohet nëse përpunimi i industrisë së mishit, pemëve, perimeve dhe verës janë rritur pas shpërndarjes së granteve në këta sektorë.

### 2.3 Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve rurale (Masa 302)

Kjo masë përfshin nën-masat si prodhimi dhe marketingu i mjaltit, përpunimi i prodhimeve bujqësore (të kultivuara) dhe marketingu i tyre, zhvillimi i aktiviteteve artizanale dhe marketingu i tyre, zhvillimi i turizmit rural dhe turizmit në fermë, akuakultura/kultivimi i peshkut dhe rritja e shpezëve për vezë dhe mish. Përkrahja në diversifikimin e bizneseve rurale dhe fermave ka për qëllim krijimin e vendeve të reja të punës dhe ruajtjen e atyre ekzistuese përmes diversifikimit, parandalimin e shpërnguljes së personave që jetojnë në zona rurale dhe malore, dhe zhvillim të qëndrueshëm në këto zona. Kjo masë mbështet edhe aktivitete të ndryshme jo bujqësore në shërbim të personave që jetojnë në zona rurale.

**Tabela 4. Shuma e ndarë në euro për sektorët e masës 302 - Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve rurale**

Masa 302					
Viti	2015	2016	2017	2018	2019
Bletaria dhe prodhimi/përpunimi dhe tregtimi i mjaltit	441,598	641,960	705,945	779,532	762,821
Përpunimi i barishteve, bimëve mjekuese, frutave pyjore dhe kërpudhave të grumbulluara	117,096	125,403	128,734	-	-
Sektori, përpunimi në fermë dhe tregtimi i prodhimeve bujqësore në shkallë të ulët (perimet, fruta, barishte, erëza, bimë mjekuese, kërpudha dhe qumështi i deleve, dhive)	180,010	216,998	212,492	634,810	-
Zhvillimi i aktiviteteve artizanale dhe marketingu i tyre	37,929	123,469	220,934	315,967	334,126
Zhvillimi i turizmit rural dhe turizmit në fermë	142,961	453,990	364,388	528,847	242,893
Përpunimi i prodhimeve bujqësore në ekonomitë familjare	-	-	-	-	303,581
Akuakultura /kultivimi i peshkut	-	-	-	-	305,639
Rritja e shpezëve për vezë dhe mish	-	-	-	-	239,005

Burimi: Raporti i Gjellbër 2015- 2020 i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Sektori i bletarisë ka vazhduar të mbështetet edhe në vitin 2014 dhe tutje, dhe është nën masa që ka përfituar më së shumti grante gjatë këtyre viteve. Disa nga investimet e pranueshme për këtë masë janë: blerja e makinerive dhe pajisjeve për prodhim dhe përpunim të mjaltit, investime në nxjerrjen e produkteve të bletës, blerja e kosherve pa bletë, ndërtimi, renovimi dhe zgjerimi i dhomës së mjaltit, etj. Grantet janë rritur për 103% që nga viti 2014 deri në vitin 2019, ndërsa prodhimi i mjaltës është rritur vetëm për 40%. Edhe pse ka pasur rritje të vazhdueshme të granteve gjatë viteve 2016 dhe 2017, prodhimtaria është zvogëluar për 64%. Mungesa e prodhimit të mjaftueshëm ka shkaktuar varësi në import ku krahasuar me vitin 2014, në vitin 2019 importi i mjaltit si sasi (ton) është rritur për 62 përqind.

<sup>10</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës. Bruto Produkti Vendor TM4 2020. Burimi: <https://bit.ly/3pLoUVP>

**Tabela 5. Indikatorët e performancës së granteve për sektorin e prodhimit dhe përpunimit të mjaltit**

Viti	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Grante (euro)	374,754	441,598	641,960	705,945	779,532	762,821
Prodhimtaria (ton)	1,568	2,120	768	982	2,946	2,198
Importi (ton)	141	177	200	197	209	229

Burimi: Raporti i Gjelbër 2015- 2020 i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

**Figura 3. Indikatorët e performancës së granteve për sektorin e prodhimit dhe përpunimit të mjaltit**



## 2.4 Zbatimi i strategjive zhvillimore lokale - qasja LEADER (Masa 303)

Me qëllim të rritjes së zhvillimit ekonomik të zonave rurale, jepen grante për Grupet Lokale të Veprimit (GLV) që ofrojnë përkrahje për përgatitjen e strategjive zhvillimore dhe zbatimin e tyre në bashkëpunim me komunitetin lokal. Kjo masë përbëhet nga tri aktivitete kryesore: përvetësimi i aftësive dhe nxitja e banorëve në vendet e GLV-ve të përzgjedhura; zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal - qasja leader dhe bashkëpunimi me banoret e vendeve ku janë të përqendruara GLV-të pas strukturimit të grupeve dhe kapacitetit të banorëve për të përfituar nga aktivitetet. Qëllimi kryesor dhe i përgjithshëm i kësaj mase është ngritja e kapaciteteve të GLV-ve të përzgjedhura, anëtarëve dhe banorëve ruralë me qëllim të përmirësimit të shkathtësive në zhvillim lokal dhe demokraci. Përkrahja për këto grupe lokale të veprimit është rritur ndër vite, ku në krahasim me vitin 2014, shumica e granteve është rritur për 188%.



**Tabela 6. Shuma e ndarë për grante (në euro) në funksionalizimin e GLV-ve të përzgjedhura**

Masa 303						
Viti	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Funksionalizimi i GLV-ve të përzgjedhura	-	83,520	79,850	-	293,087	240,184

Burimi: Raporti i Gjellbër 2015- 2020 i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Sipas Zyrës së Auditorit, nga disa raste të Grupeve Lokale të Veprimit, përfituesit nuk kanë ofruar dëshmi për realizimin e shpenzimeve siç është paraparë me projekt. Gjithashtu, nuk janë bashkangjitur dëshmi të punësimit të ekspertëve. Janë vërejtur parregullësi dhe mospërputhje në mes të agjendes dhe listës së pjesëmarrësve në trajnim.<sup>11</sup>

## 2.5 Masa për ujitjen e tokave bujqësore

Me qëllim të grumbullimit dhe akumulimit të ujit për shfrytëzimin e ujitjes së tokave bujqësore në mungesë të reshjeve të shiut gjatë veres, MBPZHR vazhdimisht ndan grante për ujitjen e tokave bujqësore. Për periudhën e zbatimit të programit për bujqësi dhe zhvillim rural 2014-2020, për këtë masë është paraparë që ndihma maksimale publike të jetë 600,000 euro për përfitues.<sup>12</sup>

Gjendja teknike e infrastrukturës së ujitjes nuk është në nivelin e duhur, prandaj një pjesë e madhe e pendave, rezervuareve, kanaleve, gypave duhet rehabilituar dhe të ketë ndërtime të reja. Objektivat e përgjithshme të kësaj mase janë rritja e prodhimit, rendimentit dhe aftësive konkurruese të prodhimeve bujqësore. Ndërsa objektivat e veçanta janë rritja e sipërfaqeve të ujitura të tokave bujqësore, modernizimi i sistemit të ujitjes, përmirësimi i rrjetit ekzistues dhe kullimi për zvogëlimin e humbjes së sasisë së ujit të përdorur.<sup>13</sup>

Krahasuar me vitin 2014, sipërfaqja e tokës së ujitur formale dhe jo formale në vitin 2019 është për 46% më e ulët, ndërsa grantet janë ulur për 23%. Në tabelën e mëposhtme shohim se gjatë vitit 2016, në krahasim me vitin 2015, grantet janë rritur për 49%, ndërsa sipërfaqja e tokës së ujitur është zvogëluar për 5%.

**Tabela 7. Indikatorët e performancës së granteve në masën ujitja e tokave bujqësore.**

Masa - Ujitja e tokave bujqësore						
Viti	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Grante (euro)	587,829	644,649	965,614	64,871	475,413	320,000
Sipërfaqja e tokës së ujitur (ha)	22,888	23,122	21,776	19,839	17,837	17,719

Burimi: Raporti i Gjellbër 2015- 2020 i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

<sup>11</sup> Zyra Kombëtare e Auditimit. Raporti i auditimit për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Burimi: <https://bit.ly/2PLmOaw>

<sup>12</sup> Masa për ujitjen e tokave bujqësore. Udhëzues për Aplikues. Burimi: <https://bit.ly/3dduHoe>

<sup>13</sup> Programi për zhvillimin Rural 2019. Agjencia për zhvillimin e bujqësisë. <https://bit.ly/3foTYLU>

### 3. Përfundimi

Zhvillimi i bujqësisë mbetet një ndër prioritetet kryesore të vendit. Kjo për shkak se ky sektor ka potencial të lartë në përmirësimin e bilancit tregtar dhe në rritjen e punësimit. Megjithatë, dhjetë vite pas hartimit të programeve kryesore për të zhvilluar këtë sektor, Kosova vazhdon të ketë prodhimtari të ulët bujqësore dhe njëkohësisht rritje të konsumit të brendshëm i cili në masë të madhe plotësohet nga importi.

Sipas Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ndër problemet kryesore që pengojnë zhvillimin e bujqësisë janë mungesa e investimeve në asete fizike të fermave apo kapaciteteve prodhuese. Për këtë arsye, ky institucion ka hartuar skemën mbështetëse të granteve i cili synon të përmirësoj këtë problem.

Nga viti 2015 deri në vitin 2019 janë ndarë rreth 104.5 milionë euro për të ndihmuar zhvillimin e sektorëve të ndryshëm të kulturave bujqësore dhe infrastrukturës fizike. Mirëpo, sipas të dhënave të prezentuara në këtë raport, shpërndarja e granteve ka vazhduar pa u vlerësuar nëse synimet e programit janë duke u realizuar. Pas hartimit dhe implementimit të programit të granteve, MBPZHR nuk ka vlerësuar në mënyrë sistematike ndikimin e kësaj skeme në arritjen e synimeve të programit.

Duke parë në njërin anë zhvillimin jo të kënaqshëm të sektorit të bujqësisë dhe mungesën e rritjes së pritur të prodhimit dhe në anën tjetër rritjen e vazhdueshme të përkrahjes financiare (48 milionë euro çdo vit), ky raport vë në pikëpyetje efektshmërinë e politikave bujqësore të hartuara mbi dhjetë vite më parë apo mënyrën e shpërndarjes së tyre. Kritika rreth menaxhimit të sektorit të bujqësisë ka pasur edhe Zyra Kombëtare e Auditimit. Madje nga muaji shkurt i vitit 2021 disa zyrtarë të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë u arrestuan nën dyshimin e keqpërdorimit të fondeve për përkrahjen bujqësore.<sup>14</sup> Pas këtyre zhvillimeve është tejet e rëndësishme të bëhet një shqyrtim i programeve bujqësore ekzistuese dhe mënyrës së implementimit të tyre. Prandaj marrë parasysh të gjeturave të këtij raporti, Instituti GAP rekomandon:

- Të bëhet një vlerësim i detajuar nëse mungesa e rezultateve të pritshme është si pasojë e politikave bujqësore joadekuate apo nga menaxhimi jo i duhur i fondeve.
- Secila masë të ketë tregues të qartë të matjes së suksesit të saj.
- Të bëhet vlerësimi i efektshmërisë së masave bazuar në indikatorët e vendosur.
- Të bëhet monitorimi i zbatimit të investimeve në asetet fizike.
- Të bëhet rishikim dhe vlerësim i rregullt i politikave bujqësore

<sup>14</sup> Gazeta "Koha Ditore". Burimi: <https://bit.ly/2PKQowv>



Institutit GAP është think-tank i themeluar në tetor të vitit 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheqë profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të plotësojë zbrazëtitë mes qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të plotësojë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

[www.institutigap.org](http://www.institutigap.org)

Rr. Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Nr.4,  
10000 Prishtine

+381 38 609 339

info@institutigap.org

---

Institutit GAP përkrahet nga:



